



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 nëntor 2019
Nr. ref.: RK 1466/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI61/19

Parashtrues

Bahrije Baftiu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.
nr. 304/2018, të 13 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bahrije Baftiu (në tekstin e mëtejme: parashtruesja), me vendbanim të përhershëm në Shtime, e cila përfaqësohet nga Labinota Qosa-Ilazi, avokate nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjyimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 304/2018, të 13 nëntorit 2018 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar), të cilin e ka pranuar më 7 dhjetor 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], në lidhje me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i Kërkesës], nenin 47 [Kërkesat Individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 prill 2019, parashtruesja e dorëzoi kërkesën nëpërmjet postës, e cila ka arritur në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), më 11 prill 2019.
6. Më 16 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 24 maj 2019, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe nga e njëjta kërkoi informata shtesë.
8. Më 17 qershor 2019, parashtruesja e kërkesës dorëzoi informata shtesë, sipas kërkesës së Gjykatës.
9. Më 15 korrik 2019, Gjykata një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme, në pajtim me ligjin.
10. Më 6 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 16 mars 2011, parashtruesja e kërkesës ushtroi padi në ish-Gjykatën Komunale në Ferizaj, tani Gjykata Themelore, kundër ndërmarrjes N.T.P. Nerakond (e paditura), me seli në Ferizaj, nëpërmjet të cilës kërkoi përmbushjen

e kontratës së punës nr. 136, të 28 korrikut 2002 nga e paditura, respektivisht pagesën e të ardhurave personale në shumën prej 7,660.00 euro, për periudhën kohore: 1 shkurt 2002 - 13 korrik 2010.

12. Më 6 maj 2014, parashtruesja e ndryshoi padinë e saj duke kërkuar edhe përmbushjen e kontratës komerciale.
13. Më 3 tetor 2016, Gjykata Themelore në Ferizaj, me Aktgjykimin C. nr. 205/06, refuzoi në tërësi padinë e parashtrueses së kërkesës, me arsyetimin se kërkesat e kërkuara me kërkesëpadi për pagesën e të ardhurave personale janë parashkruar në kuptim të nenit 372 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (LMD), sepse kontrata kishte skaduar më 21 shtator 2007, ndërsa padia nga parashtruesja e kërkesës ishte ushtruar më 5 janar 2011, përkatësisht pas kalimit të afatit prej 3 (tri) viteve.
14. Më 22 nëntor 2016, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të 3 tetorit 2016, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
15. Më 7 qershor 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ac. nr. 680/2017, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e shkallës së parë, të 3 tetorit 2016, me arsyetimin se Aktgjykimi nuk ishte përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, pika b), g), j), k) dhe m) i LPK-së.
16. Më 10 korrik 2018, parashtruesja e kërkesës ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 7 qershorit 2018, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 10 korrik 2018, Gjykata Supreme me Aktgjykimin e kontestuar, Rev. nr. 304/2018, refuzoi kërkesën për revizion të ushtruar nga parashtruesja, duke lënë në fuqi kështu aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesja pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenet 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës, me arsyetimin se: *"... asnjë nga instancat nuk ka dhënë asnjë arsyetim bazik ligjor, se si ato kishin ardhur në përfundim që sipas asaj dispozite (neni 372 i LMD i vitit 1978) ishte e pabazuar edhe pjesa e kërkesëpadisë së paditëses për periudhën kohore nga dt. 16.03.2018 deri me dt. 13.07.2010, nisur nga fakti se meqë paditësja padinë e saj e kishte paraqitur në gjykatë me dt. 16.03.2011 asnjëra nga gjykatat nuk ka pas asnjë të drejtë ligjore ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses pasi që në rastin konkret kërkesat periodike të paditëses nga 16.03.2008 deri më 13.07.2010, nuk ishin parashkruar siç parashihet me nenin 372 të LMD-së".*
19. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata: *"... që t'i analizojë me kujdes provat si: Aktvendimi Ac. nr. 4151/2015 dt. 11.01.2018, Aktvendimi Ac. nr. 3375/2014, dt. 29.05.2018, Aktvendimi Ac. nr. 3379/2014 dt. 15.12.2016*

dhe Aktgjykimi C. nr. 183/2012 dt. 22.11.2016 nga të cilat prova vërtetohet se si vendosin gjykatat tona për raste identike ...”.

20. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata të deklarojë kërkesën të pranueshme, të konstatojë se Aktgjykimi i kontestuar, Rev. nr. 304/2018, i 13 nëntorit 2018 është nxjerrë me shkelje kushtetuese në kuptim të neneve 24, 31 dhe 54, në lidhje me nenin 21 të Kushtetutës, si dhe të mundësojë përsëritjen e procedurës në çështjen kontestimore C. nr. 2015/11 pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...]”.

23. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të kërkuara me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 i Ligjit
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

24. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtuesja e kërkesës është palë e autorizuar; i ka shterur mjetet juridike në dispozicion; e ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë kushtetuese të cilat ajo pretendon se i janë shkelur me vendimin e kontestuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

25. Megjithatë, Gjykata shqyrton gjithashtu nëse parashtuesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (2) të Rregullores, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

26. Gjykata, rikujton se parashtuesja e kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 dhe 54, në lidhje me nenin 21 të Kushtetutës

27. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se parashtuesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk arsyetuan vendimet e tyre sa i përket zbatimit të nenit 372 të LMD-së, në lidhje me parashkrimin e padisë në kuptim të këtij neni. Në të vërtetë, Gjykata vëren se pretendimet në këtë pjesë ngrenë çështje të ligjit (ligjshmërisë) të cilat bien në fushëveprimin e gjykatave të rregullta dhe jo të Gjykatës Kushtetuese, sepse shkeljet e pretenduara të të drejtave të mbrojtura me këto dispozita konkrete nuk janë argumentuar dhe ngritur në nivel kushtetues (kushtetutshmërisë).
28. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj.
29. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, GJEDNJ rasti *Perlala kundër Greqisë*, paragrafi 25 dhe *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*,

paragrafi 34, dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, para. 41).

30. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, rasti KI86/11, me parashtrues *Milaim Berisha*, i 5 prillit 2012).
31. Më tej, Gjykata duke iu referuar pjesëve relevante të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, vëren se kjo e fundit përkritazi me pretendimin për parashkrimin e padisë arsyetoi: “... lidhur me faktin vendimtar të mos ndërprerjes së parashkrimit, gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e shkallës së parë kanë dhënë arsye të mjaftueshme dhe të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit për atë se si dhe në çfarë mënyre duhet të bëhet deklarimi i të paditurit për pranimin e borxhit i cili deklarim do të paraqiste ndërprerjen e parashkrimit, për çka në këtë kontekst nuk mund të pranohet si i bazuar deklarimi i revizionit se pohimi i borxhit mund të bëhet në mënyrë të thjeshtë”.
32. Për më tepër, Gjykata Supreme, arsyetoi se: “Pretendimet ... të cilat i referohen parashkrimit dhe ndërprerjes së tij, Gjykata Supreme nuk i pranon si të bazuara për faktin se në rastin konkret në mënyrë të sigurt është vërtetuar jo vetëm parashkrimi i borxhit por edhe se nga aneksi i gjashtë i kontratës së përshkruar më lart, të lidhur në mes UNMIK-ut dhe kompanisë N.T. Neraimpex, në Ferizaj, rezulton se këtë kontratë e paditura nuk e ka lidhur me punëtorët, por me UNMIK-un, kështu që kontrata është ligj për palët, por jo edhe për personat tjerë, kështu që kësaj kontrate paditësi nuk mund t’i referohet me detyrimin e të paditurës ndaj paditësit ...”.
33. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e kontestuar, ka adresuar të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës, të ngritura në kërkesën për revizion, duke dhënë arsye gjithëpërfshirëse dhe të detajuara sa i përket gjetjeve të saj. Andaj, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi të mjaftueshme që para gjykatave të rregullta t’i prezantojë të gjitha pretendimet për shkelje të të drejtave të saj. Për më tepër argumentet e saj janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta. Për këto arsye, Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta janë të arsyetuara dhe se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih rastin e GJEDNJ-së, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009).

Sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës

34. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja në kërkesë ka përmendur disa vendime të gjykatave të rregullta, duke pretenduar se në rrethana identike gjykatat e rregullta kanë vendosur ndryshe. Megjithatë e njëjta nuk ia ka

bashkëngjitur ato vendime, si dëshmi, kërkesës së saj. Andaj, Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtuesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Për këto arsye, Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtueses së kërkesës përkitazi me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, respektivisht pretendimin për trajtimin ndryshe të rastit të saj me raste të tjera identike për shkak se në këtë aspekt kërkesa nuk është e mbështetur me prova materiale.

35. Nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata vëren se parashtuesja e kërkesës thjeshtë nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta, gjegjësisht me faktin se asaj i është refuzuar kërkesëpapia nga të gjitha instancat gjyqësore. Megjithatë, pakënaqësia e parashtueses së kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005; shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastin: KI25/11, me parashtues *Shaban Gojnovci*, të 28 majit 2012, paragrafi 28; shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
36. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtueses duhet deklaruar qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese, sepse argumentet e ngritura në kërkesë në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë pretendimet e saj për shkelje të neneve 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 21 të Kushtetutës.
37. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 6 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi